

ZKM ALBANIA

2/2024



- 1993:** Themelohet në Tiranë Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë.
- 1995:** Poliklinika Atë Luigji Monti fillon veprimtarinë.
- 2004:** Hapet Universiteti Katolik.
- 2008:** Hapet Qendra e Fizioterapisë dhe e Klinikës Dentare
- 2022:** Fillon misioni i Spitalit të ri Katolik ZKM.
- 2024:** **ZKMAlbania**, me këtë revistë të përmuajshme rrëfjëmë histori dhe ushqejmë ideale.

Notizie dalla Fondazione
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO, Tirana

Lajme nga Fondacioni
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË, Tiranë

Redaksia "ZKM **ALBANIA**" 📍 Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë
📞 unikzkm 📧 unikzkm 🌐 www.unizkm.al / Per kontakti 📧 pr@fzkm.org

PAQJA NUK ËSHTË ARTIFICIALE

Papa Françesku flet për marrëdhënien ndërmjet paqes dhe inteligjencës artificiale

Tema e paqes është gjithmonë aktuale dhe nuk nënkupton vetëm mungesën e luftës. Paqja është rezistenca ndaj të keqes, përkushtimi ndaj drejtësisë, kërkimi i së mirës së përbashkët. Paqja nënkupton gjithashtu kuptimin e limiteve të njëri-tjetrit, kulturën e dialogut, meditimin dhe bukurinë. Duke vazhduar një traditë të pezulluar për shkak të pandemisë Covid-19, **të martën më datë 27 shkurt në orën 10:30**, Fondacioni propozon një konferencë të thelluar mbi Mesazhin për Ditën e Paqes 2024, me bashkëpunimin e CESPIC (Qendra Europiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim) dhe Grupit universitar CREI (Kultura dhe Burimet për Ekologjinë Integrale).



FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Përkushtuar edukimit, përkushtuar shëndetit



NUNCIATURA APOSTOLIKE
NË SHQIPËRI

në bashkëpunim me



CESPIC
European Centre
of Peace Science
Integration and Dialogue



CULTURA
RISORSE
per l'
ECOLOGIA
INTEGRALE

DITA E 57 BOTËRORE E PAQES

MESAZHI I PAPA FRANÇESKUT PËR VITIN 2024

Inteligjenca artificiale dhe paqja



27 shkurt 2024
10:30
Aula Magna
Universiteti Katolik ZKM
Tiranë, Shqipëri

Përshëndetjet hyrëse
Fr. RUGGERO VALENTINI
President i Fondacionit ZKM

Prof. LEONARDO PALOMBI
Rektor i Universitetit Katolik ZKM

Hyrje
Imzot. LUIGI BONAZZI
Nunci Apostolik në Shqipëri

Prezantim
Prof. RAUL CARUSO
Drejtor i CESPIC

Ndërhyrje
Imzot. VINCENZO PAGLIA
President i Akademisë Papnore për jetën

On. BRANDO BENIFEI
Relator i ligjit për I.A
në parlamentin Evropian

NELLO SCAVO
Korrespondent i Gazetës "Avvenire"

**DITA E 57
BOTËRORE
E PAQES**

KOSOVA: DYER TË HAPURA

Vizita e fr. Ruggero-s dhe e prof. Palombi-t



Në datë 26 janar, presidenti i Fondacionit fr. Ruggero ishte i ftuar nga autoritetet vendase në Prishtinë në takime të ndryshme: me Kryeministrin, me Ministrin e Industrisë, të Arsimit, të Shëndetësisë dhe atë të Kulturës. Më pas u takua me Ipeshkvën katolik dhe me një ekspert të kujdesit shëndetësor lokal. Fr. Ruggero theksoi se Fondacioni nuk disponon mjete lufte apo diplomatike për të vepruar dhe as burime të mëdha ekonomike, por disponon forcën e solidaritetit dhe të marrëdhënieve. Në datë 30 janar, rektori, prof. Palombi pati takime specifike në fushën e shëndetësisë, veçanërisht në fushën e pediatriës.

KOSOVË: ZOJA NË BORË!

Universiteti ofron një mundësi pas provimeve, për një udhëtim nga data 8 deri më 10 mars

Universiteti ynë ofron një mundësi entuziasmuese udhëtimi për në Kosovë pas provimeve, të quajtur "Zoja në borë", nga data 8 deri më 10 mars. Ky program do të çojë në zbulimin e qyteteve magjepsëse dhe peizazheve unike. Një aventurë e jashtëzakonshme dhe një mundësi perfekte për t'u zhytur në këtë udhëtim nëpërmjet qyteteve magjepsëse të Gjakovës, Prizrenit dhe Pejës, duke shijuar bukurinë kulturore dhe piktoreske të Kosovës në dimër. Pika kulmore do të jetë vizita në qendrën e skijimit në Brezovicë, e cila do të ofrojë momente emocionuese në dëborë. Gjithashtu, zbulimi i Ujëvarës së Drinit dhe e Manastirit të Decanit do t'i shtojë një misticizëm kësaj eksperience. Një mundësi që nuk duhet humbur, për të eksploruar magjinë e Kosovës dhe për të krijuar kujtime të paharrueshme.



PËRQAFIME SOLIDARITETI

Të kuptojmë vuajtjet në Tokën e Shenjtë

Studentët e Universitetit ZKM të shoqëruar nga Atë Paschal Mgbéadichie, vizituan së fundmi Ambasadën e Palestinës në Shqipëri duke ofruar një kontribut ekonomik të mbledhur gjatë Javës së Bamirësisë mbi emergjencat e krijuara për shkak të situatës komplekse sociale dhe politike. Ambasadorja, me një mirësjellje mallëngjyese, ndau dhimbjen e vendit të saj të përfshirë në konflikt, duke theksuar nevojën urgjente për t'i dhënë fund kësaj tragjedie dhe duke forcuar përkushtimin për paqen. Në të njëjtat ditë, ambasadorja e Izraelit në Tiranë kishte vizituar Universitetin dhe Spitalin ZKM për të njohur mundësitë e formimit në fushën e kujdesit shëndetësor.



ME MJEKUN EMANUELE STABLUM

Një udhëtim shpirtëror çdo të premte
në orën 16.30, pranë "Casa Rossa"

Çdo të premte të Kreshmës, figura e Emanuele Stablum do të na shoqërojë në një udhëtim shpirtëror prekës nëpërmjet "Rrugës së Kryqit". Në një atmosferë plot përkushtim, figura e tij do të na udhëheqë nëpërmjet stacioneve të pasionit të Jezusit, duke ofruar reflektime dhe frymëzime të thella për jetën tonë të përditshme. Kujtimi i Emanuele, plot ndjeshmëri dhe urtësi, do ta bëjë këtë moment një mundësi unike për të kultivuar spiritualitetin tonë.



FISNIK MES KOMBEVE

Një libër nga fr. Ruggero Valentini

Historia e jetës së Emanuele Stablum shtrihet në një epokë të shënuar nga dy luftëra botërore, nga diktatura dhe kampe shfarosjeje. Por nga ana tjetër ai ka përjetuar edhe euforinë e të filluarit nga e para pas këtyre tragjediave. Njeri i shuguruar, mjek, Fisnik midis Kombeve, i shpallur i Nderuar nga Kisha Katolike: në këtë kornizë të gjerë shpaloset aventura ekzistenciale, të cilën libri e rrëfen si një biografi dhe e eksploron si një hetim. Mjeku Stablum ka qenë anëtar i Komunitetit të krijuar nga Atë Monti, i cili sot është prezent në Shqipëri nëpërmjet Fondacionit ZKM. Shqipëria ka 75 (janar 2022) Fisnikë mes Kombesh të njohur nga Yad Vashem-i i Jeruzalemit. Në këtë libër gjejmë tema të vjetra dhe të reja: vokacioni dhe profesioni, shëndeti dhe kujdesi shëndetësor, etike dhe ekologjike integrale.



«Non è bene che
l'uomo sia solo» (Gen 2,18)

XXXII
GIORNATA MONDIALE DEL MALATO
11 febbraio 2024



BASHKË PËR TU KUJDESUR

Kujdesi i parë janë marrëdhëniet

Me rastin e Ditës Botërore të të Sëmureve, në datë 11 shkurt, Universiteti dhe Spitali u bashkuan për të dhënë një mesazh dashurie dhe kujdesi. Të frymëzuar nga urtësia e Biblës, motivi dominues ishte: "Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm" (Zanafilla 2:18). Studentët dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor bashkëpunojnë në aktivitete që frymëzohen nga bashkëndarja, ku promovojnë mbështetjen e dukshme ndaj atyre që përballen me sëmundje.

ZKM
ALBANIA

KOPSHTI I TË DREJTËVE

Inagurimi, datë 6 mars 2024, ora 11.30



Kush ka frekuentuar Kampusin tonë gjatë javëve të fundit ka vënë re një entuzizëm të madh, pasi është duke u ndërtuar "Kopshti i të Drejtëve", i cili do të inagurohet në Ditën evropiane të të Drejtëve të njerëzimit, e cila festohet çdo vit, në datë 6 mars. E proklamuar nga Parlamenti i Bashkimit Evropian në vitin 2012, kjo Ditë synon të përkujtojë ata të cilët kundërshtuan totalitarizmin dhe krimet kundër njerëzimit. Bibla thotë që "ai që shpëton një jetë, shpëton gjithë botën": ai është i Drejtë.

Roli i Kopshtit të të Drejtëve është të nderojë gratë dhe burrat që përballë mizorive masive marrin përgjegjësi personale për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për të ndihmuar viktimat. Kopshtet kanë për detyrë t'i paraqesin opinionit publik, si shembull të jetës, ata të cilët duke rrezikuar jetët, karrierat dhe shoqëritë e tyre, kanë qenë të aftë të shkojnë kundër rrymës dhe të ruajnë vlerat njerëzore përballë ligjeve të padrejta apo indiferencës së shoqërisë. Një njeri i Drejtë vepron sepse dëgjon thirrjen e ndërgjegjes së tij dhe i do të tjerët dhe bukurinë e jetës.

Kush do të jetë i Drejti i parë në Kopshtin tonë? Është një surprizë, por prej vitit të ardhshëm, të gjithë ata që frekuentojnë Kampusin ZKM do të mund të votojnë për të zgjedhur të Drejtin të cilit duan t'i dedikojnë një kujtim në këtë Kopsht. Me anë të kësaj nisme, Fondacioni ZKM synon të promovojë midis studentëve, midis operatorëve dhe midis të ftuarve të dimensionit spiritual të jetës, qytetarinë aktive dhe ndjeshmërinë ndaj të mirës së përbashkët. Kopshti i të Drejtëve do të kthehet në një vend spiritual, hapësirë takimesh dhe kujdesi të marrëdhënieve njerëzore.



STUDIO ARKPRO ALBANIA
Adresa: Tirana
Tel: +355 67 44 28 722
E-mail: info@arkpro.al
Web: www.arkpro.al
ARCHITET: Massimo, dipl. USB (ch) Alfonsa Shijeti

lab arch laboratorio architettura
Arch. Claudio Radice
Via General Garibaldi, 40 - 00186 Roma
Tel/Fax: +39067513252 - claudio@labarch.it



NJËZET VITE NË EVROPË

Një simbol që do të na shoqërojë në 2024

Për 20 vjetorin e Universitetit tonë është realizuar një logo nga bashkëpunëtori ynë grafik Fredi Dragusha. I gjithë mesazhi që kjo logo kërkon të përcjellë gjendet tek numri 20, ku dukshëm, përmban logon e vetë Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë". Te numri 0 (zero) duket shqiponja që shfaqet duke fluturuar, e hapur drejt së ardhmes.



☛ PANAIRI "WORK & STUDY 2024"

Që prej datës 26 shkurt deri në 4 prill 2024, do të lëvizim në Shqipëri për të promovuar Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" do të marrë pjesë në panairin "Work & Study" në qytetet: Dibër, Shkodër, Krujë, Lezhë, Kavajë, Berat, Durrës, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Fier, Lushnjë, Vlorë e Tiranë.

Mund të na gjeni në stendën UKZKM për tu informuar mbi Programet e Studimit, Bursat e Studimit, Konkursin për Maturantët dhe për tu njohur me koordinatorët, profesorët dhe studentët.



☛ ATË BINU, NJERIU QË KA ARDHUR NGA INDIA



Edhe prift edhe ekonomist: A është e mundur?

Atë Binu, 45 vjeç, pasi zgjodhi të jetojë si një njeri i shuguruar në komunitetin e të Lumit Luigi Monti, mori formim për të kryer një mision të gjithanshëm në shërbim të Ungjillit. U bë prift në vitin 2005, dhe gjithashtu u diplomua në fushën e ekonomisë në Indi, në Vendin e tij të lindjes. Prej gati tre vitesh gjendet në Shqipëri, ku kryen rolin e tij si zëvendës president i Fondacionit ZKM me detyra operative në fushën e menaxhimit. Kjo veprimtari, të cilën e ushtron me shpirtin e solidaritetit të krishterë, nuk e pengon përkushtimin e tij si prift në shërbim të Kishës lokale.

☛ HISTORI, SHKENCË DHE NDËRGJEGJE

Shqipëria socialiste e parë përmes arkitekturës



Që Shqipëria duhet të merret me të kalurën e vetë nuk është më një konsideratë e re. Shumë Vende gjenden përballë kësaj nevojë etike. Që të fillojmë ta bëjmë këtë duke u nisur nga arkitektura është një synim i guximshëm i Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit ZKM. Në sallën "Aula Magna" të Universitetit u zhvillua në datat 9-10 shkurt një konferencë me titull "Arkitektura dhe klasicizmi socialist në Shqipëri (1945-1960)", i promovuar nga qendra Kërkimore e Arkitekturës mesdhetare. U trajtua eksplorimi dhe vlerësimi i trashëgimisë së mbetur nga një periudhë vendimtare historiko-kulturore për Shqipërinë. Njohja e të kaluarës është e qenësishme për formimin e së ardhmes, dhe kjo konferencë synoi të hedhë dritë mbi një kapitull shpesh herë të lënë pas dore, por thelbësor për historinë e arkitekturës shqiptare.

KUJDESI PALIATIV

Sfidat e një shëndetësie pranë njerëzve

Tryeza e rumbullakët e zhvilluar në janar mbi temën e kujdesit paliativ – e promovuar nga rrjeti Alumni i Universitetit – goditi në shenjë: duke pasur parasysh rritjen e moshës mesatare të popullsisë, sistemet shëndetësore të Vendeve të ndryshme gjenden përballë zgjedhjeve urgjente politike për këtë çështje. Universiteti ynë i ka propozuar Qeverisë shqiptare hapjen e tre programeve Master, që aktualisht janë në pritje të një miratimi. Për informacione mund t'i drejtoheni:

✉ info@unizkm.al



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



TAVOLA ROTONDA ALUMNI UKZKM
**L'ORIZZONTE INTERNAZIONALE E
ALBANESE DELLE CURE PALLIATIVE
E DI QUELLE SIMULTANEE**

19 gennaio 2024
16:00
Aula B107

TAKIMET E ARDHSHME



CATHOLIC UNIVERSITY
OUR LADY OF GOOD COUNSEL
Twenty years in Europe



CESPIC
European Centre
of Peace Science
Engagement and Cooperation

Tavola rotonda

**LA RILEVANZA
STRATEGICA
DELLA TURCHIA
TRA EQUILIBRI
REGIONALI
E CONFLITTI**

20 marzo 2024
16:00
Aula B107



PASTORALE
UNIVERSTARIA

con udienza dal Papa



**GITA A ROMA
& ASSISI**

2-5 aprile 2024



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Da vent'anni in Europa

**L'ENERGIA
VIENE
DAL CIELO**

Per una
conversione
ecologica

22 aprile 2024
Aula Magna

**GIORNATA
MONDIALE
DELLA TERRA**

www.unizkm.al



CATHOLIC UNIVERSITY
OUR LADY OF GOOD COUNSEL
Twenty years in Europe



CESPIC
European Centre
of Peace Science
Engagement and Cooperation

**Roots of War
& Establishment
of a Lasting
Peace**

September
3-10th
2024

**SUMMER
SCHOOL**
9th edition

<https://unizkm.al/categories/cespic/posts>